

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
 SH. A. PEJË**



Zyret qendrore
 Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
 Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ligji nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjet, nr.08/L-276, nr.04/L-111, dhe numër 05/L-009. Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me 30.07.2026, njëzëri mori vendim për aprovimin e raporteve vjetore 2024-2025 dhe raporteve Knaqëshmëria e Konsumatorëve 2024-2025.

Vendim: Nr.26/2026

Raporti Vjetor 2024

Raporti Vjetor 2025

Raporti Knaqëshmeria e Konsumatoreve 2024

Raporti Knaqëshmeria e Konsumatoreve 2025

	Delegoi	Aprovoi
Emri dhe Mbiemri	Dri Cena Kryeshef Ekzekutiv	Qendresa Kukaj Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi		
Data	30.07.2026	30.07.2026



RAPORT

Hulumtim mbi kënaqshmërinë e konsumatorëve
për periudhën Janar-Dhjetor 2024 në zonën e shërbimit
të cilën e mbulon **K.R.U. “Hidrodrini” Sh.A.**

Mars, 2025



TITULLI I PROJEKTIT:

“Hulumtim mbi kënaqshmërinë e konsumatorëve”

OPERATORI EKONOMIK:



D&D Business Support Center

Rr. Xheladin Hana, Iliria Building, 10000 Prishtinë

Tel: +383 (0) 38 748 701

E-mail: info@dd-bsc.com

Web: www.dd-bsc.com

AUTORITETI KONTRAKTUES:



K.R.U “Hidrodrini” Sh.A.

Rr.”Lekë Dukagjini” nr.156, 30000 Pejë

Tel: +383 (0) 39 432 355

E-mail: info@hidrodrini.com

Web: www.hidrodrini.com

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	8
2.	METODOLOGJIA.....	9
3.	TË GJETURAT NGA HULUMTIMI	10
3.1.	Lloji i konsumatorit.....	10
4.	KATEGORIA E AMVISËRISË.....	11
4.1.	Zona e shërbimit.....	11
4.2.	Gjinia.....	12
4.3.	Punësimi i anëtarëve të familjes	13
4.4.	Numri i anëtarëve të familjes	14
4.5.	Mosha e të anketuarëve	15
4.6.	Kontrata e shërbimit me kompaninë e ujësjellësit KRUH	16
4.7.	Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit	17
4.8.	Reduktimet e ujit	18
4.9.	Koha e reduktimeve	19
4.10.	Njoftimi për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	20
4.11.	Menyra e njoftimit.....	21
4.12.	Mënyra tjera të njoftimit.....	22
4.13.	Kyqja në shërbimet e kanalizimit.....	23
4.14.	Procedurat për ankesa.....	24
4.15.	Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit	25
4.16.	Përgjigjet nga KRUH për ankesa	26
4.17.	Përgjigjet nga KRUH për ankesa	27
4.18.	Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar	28
4.19.	Pagesat e faturave të shërbimit	29
4.20.	Arsyet për mospagesë	30
4.21.	Çmimet e shërbimeve (tarifave) të KRUH.....	31
4.22.	Çmimi i shërbimeve (tarifave).....	32
4.23.	A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë	33
4.24.	A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë	34
4.25.	Ujëmatësi.....	35
4.26.	Leximi i ujëmatësit	36
4.27.	Leximi i ujëmatësit nga KRUH për herë të fundit.....	37
4.28.	Kënaqshmëria me cilësinë e ujit	38

5. KATEGORIA E BIZNESEVE/INSTITUCIONEVE	39
5.1. Zona e shërbimit.....	39
5.2. Gjinia.....	40
5.3. Punësimi i anëtarëve të familjes	41
5.4. Numri i anëtarëve të familjes	42
5.5. Moshë e të anketuarëve	43
5.6. Kontrata e shërbimit me kompaninë e ujësjellësit KRUH	44
5.7. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit	45
5.8. Reduktimet e ujit	46
5.9. Koha e reduktimeve	47
5.10. Njoftimi paraprak për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	48
5.11. Mënyra e njoftimit.....	49
5.12. Mënyra e njoftimit.....	50
5.13. Kyqja në shërbimet e kanalizimit.....	51
5.14. Procedurat për ankesa.....	52
5.15. Ankesat në dy vitet e fundit.....	53
5.16. Përgjigjet e pranuar nga KRUH rreth ankesave	54
5.17. Përgjigjet e pranuar nga KRUH rreth ankesave	55
5.18. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar	56
5.19. Pagesat e faturave të shërbimeve.....	57
5.20. Arsye për mospagesë	58
5.21. Njohja e çmimeve të shërbimeve (tarifave) të KRUH	59
5.22. Mendimi për çmimin e shërbimeve (tarifave).....	60
5.23. A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë	61
5.24. A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë	62
5.25. Ujëmatësi.....	63
5.26. Leximi i ujëmatësit	64
5.27. Leximi i ujëmatësit për herë të fundit.....	65
5.28. Kënaqshmëria me cilësinë e ujit	66
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	67
7. Aneks 1. Pyetësi	68

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Lloji i konsumatorit	10
Tabela 2. Zona e shërbimit.....	11
Tabela 3. Gjinia	12
Tabela 4. Punësimi i anëtarëve të familjes.....	13
Tabela 5. Numri i anëtarëve të familjes.....	14
Tabela 6. Moshë e të anketuarëve.....	15
Tabela 7. Kontrata e Shërbimit	16
Tabela 8. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit.....	17
Tabela 9. Reduktimet e ujit.....	18
Tabela 10. Koha e reduktimeve	19
Tabela 11. Njoftimi paraprak për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	20
Tabela 12. Mënyra e njoftimit	21
Tabela 13. Mënyra tjetër e njoftimit.....	22
Tabela 14. Kyqja në shërbimet e kanalizimit	23
Tabela 15. Procedurat për ankesa	24
Tabela 16. Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit	25
Tabela 17. Përgjigjet e pranuar për ankesa.....	26
Tabela 18. Përgjigjet nga KRUH për ankesa	27
Tabela 19. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar	28
Tabela 20. Pagesat e faturave të shërbimit.....	29
Tabela 21. Arsyjet për mospagesë	30
Tabela 22. Çmimet e tarifave të KRUH.....	31
Tabela 23. Çmimi i shërbimeve (tarifave).....	32
Tabela 24. Qartësia e faturës nga KRUH.....	33
Tabela 25. Arsyjet e mos qartësisë.....	34
Tabela 26. Ujëmatësi	35
Tabela 27. Leximi i ujëmatësit.....	36
Tabela 28. Leximi i ujëmatësit nga KRUH për herë të fundit.....	37
Tabela 29. Kënaqshmëria me cilësinë e ujit.....	38
Tabela 30. Zona e shërbimit	39
Tabela 31. Gjinia.....	40
Tabela 32. Punësimi i anëtarëve të familjes	41
Tabela 33. Numri i anëtarëve të familjes	42
Tabela 34. Moshë e të anketuarëve.....	43
Tabela 35. Kontrata e shërbimit.....	44
Tabela 36. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit.....	45
Tabela 37. Reduktimet e ujit.....	46
Tabela 38. Koha e reduktimeve	47
Tabela 39. Njoftimi paraprak për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	48
Tabela 40. Mënyra e njoftimit	49
Tabela 41. Mënyra tjetër e njoftimit.....	50
Tabela 42. Kyqja në shërbimet e kanalizimit	51
Tabela 43. Procedurat për ankesa	52
Tabela 44. Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit	53

Tabela 45. Përgjigjet e pranuar për ankesa	54
Tabela 46. Përgjigjet nga KRUH për ankesa	55
Tabela 47. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar.....	56
Tabela 48. Pagesat e faturave të shërbimit	57
Tabela 49. Arsyjet për mospagesë	58
Tabela 50. Çmimet e tarifave të KRUH	59
Tabela 51. Çmimet e shërbimeve të tarifave.....	60
Tabela 52. Qartësia e faturës nga KRUH.....	61
Tabela 53. Arsyjet e mos qartësisë	62
Tabela 54. Ujëmatësi.....	63
Tabela 55. Leximi i ujëmatësit	64
Tabela 56. Leximi i ujëmatësit nga KRUH për herë të fundit.....	65
Tabela 57. Kënaqshmëria me cilësinë e ujit	66

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Lloji i konsumatorit	10
Figura 2. Zona e Shërbimit	11
Figura 3. Gjinia	12
Figura 4. Punësimi i anëtarëve të familjes.....	13
Figura 5. Numri i anëtarëve të familjes.....	14
Figura 6. Mosha e të anketuarëve	15
Figura 7. Kontrata e shërbimit.....	16
Figura 8. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit.....	17
Figura 9. Reduktimet e ujit.....	18
Figura 10. Koha e reduktimeve	19
Figura 11. Njoftimi paraprak për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	20
Figura 12. Mënyra e njoftimit	21
Figura 13. Mënyra tjeter e njoftimit.....	22
Figura 14. Kyqja në shërbimet e kanalizimit	23
Figura 15. Procedurat për ankesa	24
Figura 16. Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit	25
Figura 17. Përgjigjet e pranuar për ankesa.....	26
Figura 18. Përgjigjet nga KRUH për ankesa	27
Figura 19. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar	28
Figura 20. Pagesat e faturave të shërbimit	29
Figura 21. Arsyjet për mospagesë	30
Figura 22. Çmimet e tarifave të KRUH.....	31
Figura 23. Çmimi i shërbimeve (tarifave).....	32
Figura 24. A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë	33
Figura 25. Arsyjet e mos qartësisë	34
Figura 26. Ujëmatësi	35
Figura 27. Leximi i ujëmatësit.....	36
Figura 28. Leximi i ujëmatësit nga KRUH për herë të fundit	37
Figura 29. Kënaqshmëria me cilësinë e ujit.....	38
Figura 30. Zona e shërbimit	39

Figura 31. Gjinia	40
Figura 32. Punësimi i anëtarëve të familjes	41
Figura 33. Numri i anëtarëve të familjes	42
Figura 34. Mosha e të anketuarëve.....	43
Figura 35. Kontrata e shërbimit	44
Figura 36. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit.....	45
Figura 37. Reduktimet e ujit.....	46
Figura 38. Koha e reduktimeve	47
Figura 39. Njoftimi paraprak për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit.....	48
Figura 40. Mënyra e njoftimit	49
Figura 41. Mënyra tjetër e njoftimit.....	50
Figura 42. Kyqja në shërbimet e kanalizimit	51
Figura 43. Procedurat për ankesa	52
Figura 44. Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit	53
Figura 45. Përgjigjet e pranuar për ankesa	54
Figura 46. Përgjigjet nga KRUH për ankesa	55
Figura 47. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar.....	56
Figura 48. Pagesat e faturave të shërbimit	57
Figura 49. Arsyjet për mospagesë	58
Figura 50. Çmimet e tarifave të KRUH	59
Figura 51. Çmimet e shërbimeve të tarifave.....	60
Figura 52. Qartësia e faturës nga KRUH.....	61
Figura 53. Arsyjet e mos qartësisë	62
Figura 54. Ujëmatësi.....	63
Figura 55. Leximi i ujëmatësit	64
Figura 56. Leximi i ujëmatësit nga KRUH për herë të fundit	65
Figura 57. Kënaqshmëria me cilësinë e ujit.....	66

1. HYRJE

Kompania Rajonale e Ujësjellësit (K.R.U.) “Hidrodrini” Sh.A. është e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve cilësore të furnizimit me ujë të pijshëm dhe menaxhimit të kanalizimeve.

Zonat të cilat i përfshin ky institucion janë:

-  Pejë
-  Klinë
-  Istog
-  Deçan
-  Junik

Hulumtimi është realizuar nga kompania konsulente D&D Business Support Center dhe është financuar nga K.R.U. Hidrodrini Sh.A. Ky hulumtim ka për qëllim matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit të cilat ofrohen nga K.R.U. Hidrodrini Sh.A. për periudhën Janar – Dhjetor 2024.

Ky studim ka për qëllim të analizojë perceptimet e konsumatorëve lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe performancën e kompanisë.

Të dhënat e mbledhura do të shërbejnë si bazë për përmirësimin e shërbimeve, duke synuar rritjen e cilësisë, përballueshmërinë ekonomike dhe forcimin e menaxhimit operativ të kompanisë. Gjithashtu, ky studim do të ndihmojë në zhvillimin e politikave që sigurojnë qasje më të mirë në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Raporti i hulumtimit është i strukturuar në dy komponentë kryesorë:

1. Analiza dhe interpretimi i të dhënave të grumbulluara.
2. Konkluzionet dhe rekomandimet bazuar në rezultatet e studimit.

Ky dokument është përgatitur nga D&D Business Support Center me qëllim të pasqyrimin të gjetjeve kryesore të hulumtimit dhe ofrimit të sugjerimeve për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve.

2. METODOLOGJIA

Ky hulumtim është realizuar me qëllim të mbledhjes dhe analizimit të mendimeve të konsumatorëve mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara nga K.R.U Hidrodrini Sh.A., me synimin që ndërmarrja të përmirësojë vazhdimisht shërbimet e saj në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e konsumatorëve. Duke marrë në konsideratë opinionet dhe përvojat e tyre, ky studim ndihmon në identifikimin e fushave ku nevojiten ndërhyrje dhe përmirësime, si dhe në vlerësimin e progresit të arritur në krahasim me vitet e kaluara.

Për realizimin e këtij studimi, është hartuar një pyetësor i strukturuar me 33 pyetje. Pyetësori përfshin 600 respondentë nga regjioni i Pejës, përfshirë komunat Pejë, Istog, Deçan, Klinë dhe Junik. Përzgjedhja e pjesëmarrësve është bërë në mënyrë që të sigurohet një përfaqësim sa më i gjerë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë parasysh faktorët gjeografikë, demografikë, socialë dhe sektorialë.

Mbledhja e të dhënave është realizuar duke kombinuar disa metoda, me qëllim sigurimin e një qasjeje sa më të lehtë për konsumatorët dhe garantimin e një mostre sa më përfaqësuese. Pyetësori është shpërndarë në format elektronike përmes platformës Google Forms, përmes thirrjeve telefonike, është publikuar në rrjete sociale dhe është dërguar përmes adresave elektronike, veçanërisht për bizneset. Gjithashtu, janë kryer intervista direkte në terren në komunat që mbulon K.R.U Hidrodrini Sh.A., për të garantuar përfshirjen e sa më shumë konsumatorëve në këtë proces.

Struktura e pyetësorit është ndarë në dy pjesë kryesore:

- ✚ **Pjesa e parë** përmban të dhëna të përgjithshme mbi profilin e të anketuarve, duke përfshirë vendbanimin, zonën e shërbimit, kategorinë e konsumatorit (amvisëri apo biznes/institucion), gjininë, përbërjen familjare dhe grup moshën.
- ✚ **Pjesa e dytë** përqendrohet në cilësinë e furnizimit me ujë dhe menaxhimin e ujërave të zeza, prania e reduktimeve të ujit, efikasitetin e trajtimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, struktura tarifore, informimi mbi ndërprerjet e furnizimit dhe vlerësimi i shërbimeve të zyrës për konsumatorë.

Përdorimi i këtyre metodave dhe përfshirja e një numri të konsiderueshëm të konsumatorëve siguron një analizë të plotë dhe të besueshme, duke ofruar një bazë të fortë për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të K.R.U Hidrodrini Sh.A. Ky hulumtim shërben si një mjet i rëndësishëm për të kuptuar sfidat, për të vlerësuar kënaqësinë e konsumatorëve dhe për të përcaktuar strategji të reja në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve.

3. TË GJETURAT NGA HULUMTIMI

3.1. Lloji i konsumatorit

Ky hulumtim përfshiu gjithsej **600 anketa**, të realizuara në zonat që mbulon K.R.U. Hidrodrini Sh.A., duke i klasifikuar të anketuarit në dy kategori kryesore: **amvisëritë** dhe **bizneset/institucionet**. Prej këtij numri, **450 anketa (75%)** përfaqësojnë **amvisëritë**, ndërsa **150 anketa (25%)** janë realizuar me **bizneset dhe institucionet**. Ky ndarje pasqyron përfaqësimin e dy grupeve të ndryshme të konsumatorëve, duke ofruar një pamje të qartë të nevojave dhe kënaqësisë së tyre me shërbimet e ofruara nga K.R.U. Hidrodrini. Për më tepër, të dhënat e detajuara përkatëse janë përfshirë në **tabelën dhe figurën 1** të raportit, ku pasqyrohet shpërndarja e anketave sipas komunave të ndryshme dhe ofrohet një pasqyrë më e thelluar e situatës për çdo zonë të mbuluar nga kompania. Kjo ndarje është e rëndësishme për të kuptuar më mirë shpërndarjen e shërbimeve dhe nivelin e kënaqësisë në nivel lokal.

Qytet	Amviseri	Biznese/Institucione	Totali
Pejë	167	55	222
	75.23%	24.77%	37.00%
Istog	93	35	128
	72.66%	27.34%	21.33%
Deçan	75	30	105
	71.43%	28.57%	17.50%
Klinë	65	20	85
	76.47%	23.53%	14.17%
Junik	50	10	60
	83.33%	16.67%	10.00%
Total	450	150	600
	75.00%	25.00%	100.00%

Tabela 1. Lloji i konsumatorit




Figura 1. Lloji i konsumatorit

4. KATEGORIA E AMVISËRISË

4.1. Zona e shërbimit

Nga **450** të anketuarit e kategorisë së amvisërisë, **282 persona (62.67%)** janë nga zonat **urbane**, ndërsa **168 persona (37.33%)** janë nga zonat **rurale**. Ky rezultat tregon një përqendrim më të madh të konsumatorëve familjarë në zonat urbane, duke pasur parasysh që ato janë zona më të populluara dhe më të zhvilluara. Kjo ndarje mund të reflektojë gjithashtu ndryshimet në kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve në këto dy zona. Të dhënat e detajuara mbi këtë shpërndarje janë pasqyruar në **tabelën dhe grafikun përkatës** të raportit, të cilat ofrojnë një pasqyrë më të thelluar të përqindjes së konsumatorëve në secilën zonë dhe mund të ndihmojnë në analizimin e kërkesave të ndryshme për shërbime në zonat urbane dhe rurale.

Qytet	Urban	Rural	Totali
Pejë	132	35	167
	79.04%	20.96%	37.11%
Istog	57	36	93
	61.29%	38.71%	20.67%
Deçan	40	35	75
	53.33%	46.67%	16.67%
Klinë	45	20	65
	69.23%	30.77%	14.44%
Junik	8	42	50
	2.84%	25.00%	11.11%
Total	282	168	450
	62.67%	37.33%	100.00%

Tabela 2. Zona e shërbimit




Figura 2. Zona e Shërbimit

4.2. Gjinia

Në sektorin e amvisërisë, nga **450** të anketuar, **173 (38.44%)** janë femra dhe **277 (61.56%)** janë meshkuj. Ky rezultat tregon një pjesëmarrje më të madhe të meshkujve në anketim, duke reflektuar një përqindje më të lartë të meshkujve që kanë marrë pjesë në procesin e pyetësorëve. Kjo shpërndarje mund të tregojë një përfaqësim më të madh të meshkujve në përgjigjen ndaj pyetjeve, duke sugjeruar se ata janë më të pranishëm në këtë proces në krahasim me femrat. Detajet e këtyre të dhënave janë të rëndësishme për të kuptuar përfshirjen e grupeve të ndryshme në hulumtim dhe mund të ndihmojnë në përcaktimin e mënyrës së targetimit të grupeve të ndryshme në analizat e ardhshme.

Qytet	Femer	Mashkull	Totali
Pejë	66 39.52%	101 60.48%	167 37.11%
Istog	27 29.03%	66 70.97%	93 20.67%
Deçan	21 28.00%	54 72.00%	75 16.67%
Klinë	38 58.46%	27 41.54%	65 14.44%
Junik	21 12.14%	29 10.47%	50 11.11%
Total	173 38.44%	277 61.56%	450 100.00%

Tabela 3. Gjinia




Figura 3. Gjinia

4.3. Punësimi i anëtarëve të familjes

Në lidhje me pyetjen “A keni ndonjë anëtar të familjes të punësuar?”, shumica dërrmuese e të anketuarve në sektorin e amvisërisë janë përgjigjur pozitivisht. Konkretisht, **417 (92.67%)** kanë deklaruar se kanë anëtarë të punësuar në familje, ndërsa vetëm **33 (7.33%)** kanë thënë jo.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	155	12	167
	92.81%	7.19%	37.11%
Istog	89	4	93
	95.70%	4.30%	20.67%
Deçan	67	8	75
	89.33%	10.67%	16.67%
Klinë	59	6	65
	90.77%	9.23%	14.44%
Junik	47	3	50
	11.27%	9.09%	11.11%
Total	417	33	450
	92.67%	7.33%	100.00%

Tabela 4. Punësimi i anëtarëve të familjes




Figura 4. Punësimi i anëtarëve të familjes

4.4. Numri i anëtarëve të familjes

Në hulumtimin e realizuar për sektorin e amvisërisë, **301 familje (66.89%)** kanë deklaruar se përbëhen nga **1 deri në 4 anëtarë**, ndërsa **149 familje (33.11%)** kanë nga **5 deri në 9 anëtarë**. Këto të dhëna pasqyrojnë një tendencë dominimi të familjeve të vogla, ku shumica e tyre kanë nga 1 deri në 4 anëtarë, duke pasqyruar një strukturë më të përqendruar dhe një mundësi më të lehtë për menaxhimin e shërbimeve si ai i ujësjellësit. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e familjeve **149 familje (33.11%)** janë më të mëdha, me nga **5 deri në 9 anëtarë**, duke sugjeruar se ekzistojnë ende familje me struktura më të gjera. Ky rezultat mund të jetë i rëndësishëm për të kuptuar nevojat e ndryshme të grupeve të familjeve dhe ndikimin e madhësisë së familjes në përdorimin dhe menaxhimin e shërbimeve publike, përfshirë ato të ujësjellësit.

Qytet	1 --4	5--9	Totali
Pejë	116 69.46%	51 30.54%	167 37.11%
Istog	74 79.57%	19 20.43%	93 20.67%
Deçan	35 46.67%	40 53.33%	75 16.67%
Klinë	42 64.62%	23 35.38%	65 14.44%
Junik	34 11.30%	16 10.74%	50 11.11%
Total	301 66.89%	149 33.11%	450 100.00%

Tabela 5. Numri i anëtarëve të familjes




Figura 5. Numri i anëtarëve të familjes

4.5. Moshë e të anketuarëve

Të anketuarit në kategorinë e amvisërisë kryesisht i përkasin grup moshave **31-40 vjeç (166 persona apo 36.89%)** dhe **20-30 vjeç (132 persona apo 29.33%)**, duke treguar një përqendrim më të madh në këto dy grupe moshore. Kjo shpërndarje sugjeron se individët në këto moshat janë më aktivë në çështjet që lidhen me shërbimet e ujësjellësit, si përdorimi i shërbimeve dhe pagesat e faturave. Ndërsa për grup moshat e tjera, **41-50 vjeç (72 persona apo 16.00%)**, **51-60 vjeç (66 persona apo 14.67%)**, dhe mbi **61 vjeç (14 persona apo 3.11%)**, vërehet një pjesëmarrje më e vogël. Ky përfaqësim mund të reflektojë më pak angazhim direkt në menaxhimin e shërbimeve të përditshme, por ende është i rëndësishëm për kuptimin e ndikimit të moshave të ndryshme në përdorimin e shërbimeve publike.

Të dhënat janë pasqyruar në tabelën dhe grafikun përkatës për një analizë më të detajuar.

Qytet	20-30	31-40	41-50	51-60	61+	Totali
Pejë	39 23.35%	66 39.52%	22 13.17%	35 20.96%	5 2.99%	167 37.11%
Istog	36 38.71%	30 32.26%	16 17.20%	10 10.75%	1 1.08%	93 20.67%
Deçan	18 24.00%	29 38.67%	14 18.67%	10 13.33%	4 5.33%	75 16.67%
Klinë	25 38.46%	26 40.00%	8 12.31%	6 9.23%	0 0.00%	65 14.44%
Junik	14 28.00%	15 30.00%	12 24.00%	5 10.00%	4 8.00%	50 11.11%
Total	132 29.33%	166 36.89%	72 16.00%	66 14.67%	14 3.11%	450 100.00%

Tabela 6. Moshë e të anketuarëve




Figura 6. Moshë e të anketuarëve

4.6. Kontrata e shërbimit me kompaninë e ujësjellësit KRUH

Në pyetjen lidhur me kontratën e shërbimit me K.R.U. Hidrodrini, shumica e të anketuarve në kategorinë e amvisërisë kanë konfirmuar se e kanë të lidhur një kontratë. Konkretisht, **428 (95.11%)** e kanë pohuar këtë, duke treguar një shkallë të lartë të formalizimit të shërbimit. Nga ana tjetër, **22 (4.89%)** të anketuar kanë deklaruar se nuk e kanë lidhur ende një kontratë. Këto rezultate sugjerojnë se shumica e familjeve janë të angazhuara në një marrëdhënie formale me shërbimin e ujësjellësit, por ekziston një grup i vogël që nuk e ka bërë këtë hap, duke treguar mundësinë për përpjekje të mëtejshme në edukimin dhe motivimin e këtyre familjeve për të formalizuar shërbimin e tyre.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	167	0	167
	100.00%	0.00%	37.11%
Istog	91	2	93
	97.85%	2.15%	20.67%
Deçan	75	0	75
	100.00%	0.00%	16.67%
Klinë	65	0	65
	100.00%	0.00%	14.44%
Junik	30	20	50
	7.01%	90.91%	11.11%
Total	428	22	450
	95.11%	4.89%	100.00%

Tabela 7. Kontrata e Shërbimit




Figura 7. Kontrata e shërbimit

4.7. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit

Sa i përket kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ujësjellësit, shumica e të anketuarve kanë shprehur një vlerësim pozitiv. Konkretisht, **342 (76.00%)** janë të kënaqur me shërbimin, **87 (19.33%)** janë deri diku të kënaqur, **14 (3.11%)** janë deri diku të pakënaqur, dhe vetëm **7 (1.56%)** janë të pakënaqur. Këto rezultate tregojnë një nivel të lartë të kënaqshmërisë mes shumicës së konsumatorëve, ku më shumë se tre të katërtat janë të kënaqur ose deri diku të kënaqur. Megjithatë, ka një përqindje të vogël të konsumatorëve që shprehin shqetësime të caktuara për shërbimin, duke sugjeruar mundësinë për përmirësime të mëtejshme në ofrimin e shërbimit.

Qytet	I kënaqur	Deri diku i kënaqur	Deri diku i pakënaqur	I pakënaqur	Totali
Pejë	134	30	2	1	167
	80.24%	17.96%	1.20%	0.60%	37.11%
Istog	61	25	5	2	93
	65.59%	26.88%	5.38%	2.15%	20.67%
Deçan	58	15	1	1	75
	77.33%	20.00%	1.33%	1.33%	16.67%
Klinë	44	15	4	2	65
	67.69%	23.08%	6.15%	3.08%	14.44%
Junik	45	2	2	1	50
	90.00%	4.00%	4.00%	2.00%	11.11%
Total	342	87	14	7	450
	76.00%	19.33%	3.11%	1.56%	100.00%

Tabela 8. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit




Figura 8. Kënaqshmëria me shërbimet e ujësjellësit

4.8. Reduktimet e ujit

Në pyetjen lidhur me reduktimet e ujit, **339 (75.33%)** kanë thënë se nuk kanë probleme me furnizimin me ujë, ndërsa **111 (24.67%)** e të anketuarve kanë deklaruar se përballen me reduktime të ujit, Këto të dhëna tregojnë se një pjesë e vogël e konsumatorëve përjeton ndërprerje të shërbimit, ndërsa shumica ka një furnizim të vazhdueshëm dhe pa ndërprerje.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	22 13.17%	145 86.83%	167 37.11%
Istog	41 44.09%	52 55.91%	93 20.67%
Deçan	10 13.33%	65 86.67%	75 16.67%
Klinë	30 46.15%	35 53.85%	65 14.44%
Junik	8 7.21%	42 12.39%	50 11.11%
Total	111 24.67%	339 75.33%	450 100.00%

Tabela 9. Reduktimet e ujit




Figura 9. Reduktimet e ujit

4.9. Koha e reduktimeve

Ata që kanë raportuar se kanë probleme me reduktimet e ujit janë pyetur se gjatë cilës periudhë të ditës ndodhin këto ndërprerje. Përgjigjet janë si vijon: **49 (44.14%)** kanë thënë se reduktimet ndodhin në mëngjes, **55 (49.55%)** gjatë ditës, dhe **7 (6.31%)** në mbrëmje. Këto të dhëna tregojnë se reduktimet më të shpeshta ndodhin gjatë ditës, me një përqindje të lartë të konsumatorëve që përjetojnë ndërprerje gjatë orëve të pasdites.

Qytet	Në mëngjes	Gjatë ditës	Në mbrëmje	Totali
Pejë	8	11	3	22
	36.36%	50.00%	13.64%	19.82%
Istog	17	21	3	41
	41.46%	51.22%	7.32%	36.94%
Deçan	6	3	1	10
	60.00%	30.00%	10.00%	9.01%
Klinë	13	17	0	30
	43.33%	56.67%	0.00%	27.03%
Junik	5	3	0	8
	62.50%	37.50%	0.00%	7.21%
Total	49	55	7	111
	44.14%	49.55%	6.31%	100.00%

Tabela 10. Koha e reduktimeve




Figura 10. Koha e reduktimeve

4.10. Njoftimi për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit

Përsa i përket njoftimit mbi ndërprerjet e ujësjellësit, **308 (68.44%)** e të anketuarve kanë deklaruar se njoftohen për ndërprerjet e mundshme të shërbimit, ndërsa **61 (13.56%)** kanë thënë se nuk njoftohen paraprakisht. Megjithatë, një pjesë e vogël e konsumatorëve, ndërsa **81 (18%)**, ende nuk janë të informuar në mënyrë të rregullt por kohë pas kohe.

Të dhënat e plota janë paraqitur në tabelën dhe grafikun përkatës.

Qytet	Po	Jo	Ndonjëherë	Totali
Pejë	123	23	21	167
	73.65%	13.77%	12.57%	37.11%
Istog	69	16	8	93
	74.19%	17.20%	8.60%	20.67%
Deçan	57	9	9	75
	76.00%	12.00%	12.00%	16.67%
Klinë	17	12	36	65
	26.15%	18.46%	55.38%	14.44%
Junik	42	1	7	50
	13.64%	1.64%	8.64%	11.11%
Total	308	61	81	450
	68.44%	13.56%	18.00%	100.00%

Tabela 11. Njoftimi paraprak për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit




Figura 11. Njoftimi paraprak për ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit

4.11. Menyra e njoftimit

Ata që janë njoftuar për ndërprerjet e ujësjellësit janë pyetur se në çfarë mënyre kanë marrë informacionin. Nga përgjigjet e dhëna, **27 (8.77%)** kanë deklaruar se janë njoftuar përmes lexuesit, **39 (12.66%)** përmes radios, **115 (37.32%)** përmes web faqes dhe **62 (20.13%)** përmes telefonit. Mënyra më e përdorur për njoftimin e ndërprerjeve është web faja, që tregon se kjo platformë është burimi kryesor i informacionit për shumicën e konsumatorëve. Pavarësisht se web faja është më e popullarizuara, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, **62 (20.13%)**, janë njoftuar përmes telefonit, që është një mundësi e drejtpërdrejtë dhe personale për të marrë informacion.

Qytet	Lexuesi	Përmes Radios	Përmes ueb-faqes	Telefonit	Menyre tjetër	Totali
Pejë	8 6.50%	4 3.25%	60 48.78%	28 22.76%	23 18.70%	123 39.94%
Istog	16 23.19%	8 11.59%	30 43.48%	11 15.94%	4 5.80%	69 22.40%
Deçan	1 1.75%	0 0.00%	6 10.53%	16 28.07%	34 59.65%	57 18.51%
Klinë	0 0.00%	1 5.88%	11 64.71%	3 17.65%	2 11.76%	17 5.52%
Junik	2 4.76%	26 61.90%	8 19.05%	4 9.52%	2 4.76%	42 13.64%
Total	27 8.77%	39 12.66%	115 37.34%	62 20.13%	65 21.10%	308 100.00%

Tabela 12. Mënyra e njoftimit




Figura 12. Mënyra e njoftimit

4.12. Mënyra tjera të njoftimit

Të anketuarit janë pyetur nëse kanë mundësi të tjera njoftimi për ndërprerjet e ujësjellësit. **65 (100%)** kanë deklaruar se njoftohen përmes lajmeve, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve përdorin këtë mënyrë për të marrë informacionin. Kjo sugjeron se mediat e lajmeve janë një burim i rëndësishëm për njoftimet lidhur me ndërprerjet e shërbimit. Të dhënat e detajuara janë pasqyruar në tabelën dhe grafikun më poshtë.

Qytet	Lajme	Totali
Pejë	23 35.38%	23 35.38%
Istog	4 6.15%	4 6.15%
Deçan	34 52.31%	34 52.31%
Klinë	2 3.08%	2 3.08%
Junik	2 3.08%	2 3.08%
Total	65 100.00%	65 100.00%

Tabela 13. Mënyra tjeter e njoftimit




Figura 13. Mënyra tjeter e njoftimit

4.13. Kyqja në shërbimet e kanalizimit

Në kategorinë e amvisërisë, **443 (98.43%)** e të anketuarve kanë deklaruar se janë të kyçur në shërbimet e kanalizimit, ndërsa vetëm **7 (1.56%)** kanë thënë se nuk janë të kyçur. Këto të dhëna pasqyrojnë një nivel të lartë përfshirjeje të amvisërive në shërbimet e kanalizimit, duke treguar se shumica dërrmuese e familjeve të anketuara kanë akses të plotë në këtë shërbim esencial.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	162	5	167
	97.01%	2.99%	37.11%
Istog	92	1	93
	98.92%	1.08%	20.67%
Deçan	75	0	75
	100.00%	0.00%	16.67%
Klinë	64	1	65
	98.46%	1.54%	14.44%
Junik	50	0	50
	11.29%	0.00%	11.11%
Total	443	7	450
	98.44%	1.56%	100.00%

Tabela 14. Kyqja në shërbimet e kanalizimit




Figura 14. Kyqja në shërbimet e kanalizimit

4.14. Procedurat për ankesa

Pjesë e hulumtimit ka qenë edhe pyetja nëse të anketuarit janë të njohur me procedurat për ankesa. Nga **450** të anketuar, **359 (79.33%)** kanë deklaruar se janë të njohur me këto procedura, ndërsa **91 (20.67%)** nuk kanë njohuri mbi to. Këto të dhëna sugjerojnë se shumica e të anketuarve janë të informuar mbi mënyrën e paraqitjes së ankesave, ndërsa një përqindje e vogël nuk ka njohuri për këto procese, duke treguar nevojën për përmirësimin e informimit dhe mbështetjes për ata që nuk janë të njohur me procedurat për ankesa.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	130	37	167
	77.84%	22.16%	37.11%
Istog	79	14	93
	84.95%	15.05%	20.67%
Deçan	51	24	75
	68.00%	32.00%	16.67%
Klinë	59	6	65
	90.77%	9.23%	14.44%
Junik	40	10	50
	11.14%	10.99%	11.11%
Total	359	91	450
	79.78%	20.22%	100.00%

Tabela 15. Procedurat për ankesa




Figura 15. Procedurat për ankesa

4.15. Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit

Siç pasqyrohen të dhënat në tabelë dhe në graf, **49 (10.89%)** e të anketuarve kanë deklaruar se kanë paraqitur ankesa ndaj KRUH në dy vitet e fundit, ndërsa **401 (89.11%)** kanë thënë se nuk kanë pasur nevojë të paraqesin ankesa. Kjo tregon se një pjesë e vogël e konsumatorëve janë angazhuar në paraqitjen e ankesave, ndërsa shumica nuk kanë hasur probleme të tilla që kërkojnë ndërhyrjen e shërbimit. Ky përqindje mund të reflektojë një nivel të kënaqshmërisë në shumicën e rasteve, por gjithashtu mund të tregojë mungesën e ndërgjegjësimit ose interesit për të raportuar ndodhitë që mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	9 5.39%	158 94.61%	167 37.11%
Istog	19 20.43%	74 79.57%	93 20.67%
Deçan	6 8.00%	69 92.00%	75 16.67%
Klinë	9 13.85%	56 86.15%	65 14.44%
Junik	6 12.24%	44 10.97%	50 11.11%
Total	49 10.89%	401 89.11%	450 100.00%

Tabela 16. Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit




Figura 16. Ankesat e KRUH në dy vitet e fundit

4.16. Përgjigjet nga KRUH për ankesa

Nga ata që kanë paraqitur ankesa, **31 (63.27%)** kanë marrë përgjigje nga K.R.U Hidrodrini Sh.A, **13 (26.53%)** nuk kanë marrë përgjigje, dhe **5 (10.20%)** kanë marrë përgjigje ndonjëherë. Këto të dhëna tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e atyre që kanë paraqitur ankesa kanë marrë një reagim nga KRUH, megjithatë, ka ende një numër të konsiderueshëm që nuk kanë marrë përgjigje ose kanë pasur ndonjëherë reagime.

Të dhënat e plota janë pasqyruar në tabelën dhe grafikun përkatës në raport.

Qytet	Po	Jo	Ndonjëherë	Totali
Pejë	7 77.78%	2 22.22%	0 0.00%	9 18.37%
Istog	14 73.68%	5 26.32%	0 0.00%	19 38.78%
Deçan	1 16.67%	3 50.00%	2 33.33%	6 12.24%
Klinë	5 55.56%	1 11.11%	3 33.33%	9 18.37%
Junik	4 12.90%	2 15.38%	0 0.00%	6 12.24%
Total	31 63.27%	13 26.53%	5 10.20%	49 100.00%

Tabela 17. Përgjigjet e pranura për ankesa




Figura 17. Përgjigjet e pranura për ankesa

4.17. Përgjigjet nga KRUH për ankesa

Të anketuarit që kanë paraqitur ankesa janë pyetur se si janë përgjigjur nga K.R.U Hidrodrini Sh.A. Prej tyre, **25 (75.76%)** kanë thënë se kanë marrë përgjigje nga qendra e thirrjeve, **6 (18.18%)** nga ndonjë punonjës i RWCH, dhe **2 (6.06%)** nuk e dinë se nga kush kanë marrë përgjigje. Këto të dhëna tregojnë se përgjigjet kryesore vijnë nga qendra e thirrjeve, ndërsa një numër i vogël ka marrë përgjigje nga punonjës të tjerë.

Qytet	Qendra e thirrjeve është përgjigjur	Nga ndonjë punëtor i RWCH	Nuk e di	Totali
Pejë	6	3	0	9
	66.67%	33.33%	0.00%	27.27%
Istog	10	2	2	14
	71.43%	14.29%	14.29%	42.42%
Deçan	0	1	0	1
	0.00%	100.00%	0.00%	3.03%
Klinë	5	0	0	5
	100.00%	0.00%	0.00%	15.15%
Junik	4	0	0	4
	16.00%	0.00%	0.00%	12.12%
Total	25	6	2	33
	75.76%	18.18%	6.06%	100.00%

Tabela 18. Përgjigjet nga KRUH për ankesa




Figura 18. Përgjigjet nga KRUH për ankesa

4.18. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar

Konsumatorët që kanë marrë përgjigje nga stafi i KRUH janë pyetur për kënaqësinë e tyre me shërbimin. Nga ata, **23 (69.70%)** janë shprehur të kënaqur, **10 (30.30%)** deri diku të kënaqur, ndërsa nuk ka pasur asnjë që ka shprehur pakënaqësi. Këto rezultate tregojnë një nivel të lartë kënaqësie me përgjigjet e marra nga stafi i KRUH, duke reflektuar një përpjekje pozitive nga ana e shërbimit për të adresuar shqetësimet e konsumatorëve.

Qytet	I kënaqur	Deri diku I kënaqur	Deri diku I pakënaqur	I pakënaqur	Totali
Pejë	5	4	0	0	9
	55.56%	44.44%	0.00%	0.00%	27.27%
Istog	10	4	0	0	14
	71.43%	28.57%	0.00%	0.00%	42.42%
Deçan	1	0	0	0	1
	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	3.03%
Klinë	4	1	0	0	5
	80.00%	20.00%	0.00%	0.00%	15.15%
Junik	3	1	0	0	4
	75.00%	25.00%	0.00%	0.00%	12.12%
Total	23	10	0	0	33
	69.70%	30.30%	0.00%	0.00%	100.00%

Tabela 19. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar




Figura 19. Kënaqshmëria me përgjigjen e pranuar

4.19. Pagesat e faturave të shërbimit

Në kategorinë e amvisërisë, **439 (97.56%)** e të anketuarve kanë deklaruar se paguajnë faturat me rregull, ndërsa **11 (2.44%)** kanë thënë se nuk i paguajnë me rregull. Këto të dhëna tregojnë se shumica e amvisërive janë të disiplinuar në pagesat e faturave, duke reflektuar një qëndrim të përgjegjshëm ndaj detyrimeve financiare për shërbimet e ujësjellësit. Pavarësisht kësaj, një pjesë e vogël e konsumatorëve duket se hasin vështirësi në përmbushjen e këtyre detyrimeve, çka mund të kërkojë ndërhyrje për të adresuar mundësitë e pagesave më fleksibël ose mbështetje për ata që kanë vështirësi ekonomike.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	165	2	167
	98.80%	1.20%	37.11%
Istog	90	3	93
	96.77%	3.23%	20.67%
Deçan	73	2	75
	97.33%	2.67%	16.67%
Klinë	64	1	65
	98.46%	1.54%	14.44%
Junik	47	3	50
	10.71%	27.27%	11.11%
Total	439	11	450
	97.56%	2.44%	100.00%

Tabela 20. Pagesat e faturave të shërbimit




Figura 20. Pagesat e faturave të shërbimit

4.20. Arsyet për mospagesë

Ata që nuk paguajnë faturat me rregull janë pyetur për arsyt e mospagimit. **10 (90.91%)** kanë shprehur se arsyeja kryesore është gjendja ekonomike, ndërsa **1 (9.09%)** ka deklaruar se shkak është pakënaqësia me lexuesin. Këto të dhëna tregojnë se arsyeja kryesore për mospagimin e faturave është vështirësia ekonomike, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve po hasin vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare. Në anën tjetër, pakënaqësitë me shërbimin e lexuesit janë shumë të pakta, çka sugjeron se problemet e mospagimit janë më shumë të lidhura me situatën e përgjithshme ekonomike të individëve, se sa me cilësinë e shërbimit.

Qytet	Gjendja ekonomike	Paknaqesi me lexuesin	Totali
Pejë	2	0	2
	100.00%	0.00%	18.18%
Istog	3	0	3
	100.00%	0.00%	27.27%
Deçan	1	1	2
	50.00%	50.00%	18.18%
Klinë	1	0	1
	100.00%	0.00%	9.09%
Junik	3	0	3
	100.00%	0.00%	27.27%
Total	10	1	11
	90.91%	9.09%	100.00%

Tabela 21. Arsyet për mospagesë




Figura 21. Arsyet për mospagesë

4.21. Çmimet e shërbimeve (tarifave) të KRUH

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur statistika në lidhje me sa janë të njohur me çmimet e shërbimeve të KRUH. Nga totali **450** të anketuarit e kategorisë së amvisërisë prej tyre **438 (97.33%)** janë shprehur se janë të dijeni për këto çmime dhe **12 (2.67%)** prej tyre shprehen se nuk janë të njohur me çmimet e shërbimeve (tarifave) të KRUH.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	163	4	167
	97.60%	2.40%	37.11%
Istog	91	2	93
	97.85%	2.15%	20.67%
Deçan	73	2	75
	97.33%	2.67%	16.67%
Klinë	61	4	65
	93.85%	6.15%	14.44%
Junik	50	0	50
	11.42%	0.00%	11.11%
Total	438	12	450
	97.33%	2.67%	100.00%

Tabela 22. Çmimet e tarifave të KRUH




Figura 22. Çmimet e tarifave të KRUH

4.22. Çmimi i shërbimeve (tarifave)

Të anketuarit që janë pyetur për çmimet janë gjithashtu pyetur se çfarë mendojnë për to. **331 (75.57%)** kanë thënë se çmimet janë reale, **52 (11.87%)** i kanë vlerësuar si të ulëta, dhe **55 (12.56%)** i kanë konsideruar si të larta. Këto të dhëna tregojnë se shumica e konsumatorëve e konsiderojnë çmimin e shërbimit si të drejtë, ndërsa një pjesë e vogël e sheh çmimin si të ulët ose të lartë.

Qytet	Reale	I ulët	I lartë	Totali
Pejë	143 87.73%	7 4.29%	13 7.98%	163 37.21%
Istog	74 81.32%	3 3.30%	14 15.38%	91 20.78%
Deçan	49 67.12%	8 10.96%	16 21.92%	73 16.67%
Klinë	53 86.89%	2 3.28%	6 9.84%	61 13.93%
Junik	12 3.63%	32 61.54%	6 10.91%	50 11.42%
Total	331 75.57%	52 11.87%	55 12.56%	438 100.00%

Tabela 23. Çmimi i shërbimeve (tarifave)




Figura 23. Çmimi i shërbimeve (tarifave)

4.23. A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë

Në kategorinë e amvisërisë, **430 (95.56%)** e të anketuarve kanë deklaruar se fatura nga KRUH është e kuptueshme dhe e qartë, ndërsa **20 (4.44%)** kanë thënë se nuk është e kuptueshme. Këto të dhëna tregojnë se shumica e amvisërive janë të kënaqura me qartësinë e faturave, ndërsa një numër i vogël ka pasur vështirësi në kuptimin e tyre.

Qytet	Po	Jo	Totali
Pejë	164 98.20%	3 1.80%	167 37.11%
Istog	89 95.70%	4 4.30%	93 20.67%
Deçan	67 89.33%	8 10.67%	75 16.67%
Klinë	63 96.92%	2 3.08%	65 14.44%
Junik	47 10.93%	3 15.00%	50 11.11%
Total	430 95.56%	20 4.44%	450 100.00%

Tabela 24. Qartësia e faturës nga KRUH




Figura 24. A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë

4.24. A është fatura nga KRUH e kuptueshme dhe e qartë

Të anketuarit që kanë thënë se fatura nga KRUH nuk është e kuptueshme dhe e qartë janë pyetur për arsyet e kësaj. **20 (100%)** prej tyre kanë konstatuar se ngjyra shumë zbehtë e faturës është arsyeja kryesore pse e kanë konsideruar të paqartë. Kjo tregon se ngjyra e përdorur mund të ketë krijuar vështirësi në lexueshmërinë e faturës për disa.

Qytet	Ngjyra shumë e zbehtë	Totali
Pejë	3	3
	15.00%	15.00%
Istog	4	4
	20.00%	20.00%
Deçan	8	8
	40.00%	40.00%
Klinë	2	2
	10.00%	10.00%
Junik	3	3
	15.00%	15.00%
Total	20	20
	100.00%	100.00%

Tabela 25. Arsyet e mos qartësisë




